



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 5 regjistër (JR)
Datë 20.01.2020

Nr. 3 i vendimit
Datë 23.02.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 23.02.2022, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Malo (Orhani), gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 179/b, pika 5, Aneksi i Kushtetutës, neni F, ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 63 dhe 66, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6, ligji nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 46.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe

pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Malo (Orhani) (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Korçë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportin e hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas të cilit: a). *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të pasurive nga aktiviteti privat i bashkëshortit; b). nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë ndër vite; c). nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d). nuk ka kryer deklarim të rremë; e). subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave, si dhe raportet e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe të Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).*
3. Komisioni vendosi të përfundonte procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, pasi kishte filluar procesin e rivlerësimit në tërësi, duke vlerësuar njëkohësisht se ky vendim nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar për dy kriteret e tjera, atë të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Pas hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, datë 04.11.2019, trupi gjykues i Komisionit vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e konkluzioneve të mëposhtme.

*53. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor se shoqëria “{***}” ShPK ka shpërndarë dividend ndër vite. Nuk u disponua asnjë vendim i shoqërisë për shpërndarje dividendi. Nuk u provua në asnjë formë se ky dividend është marrë nga bashkëshorti i subjektit dhe për të të jetë paguar tatimi mbi dividendin. Subjekti arriti të provojë me dokumentacion vetëm fitimin neto të shoqërisë.*

54. Nga ana tjetër, referuar dokumentacionit të administruar në dosje, ka rezultuar se shoqëria “{***}” ShPK ka kryer zmadhim të kapitalit në vitin 2006, duke përdorur fitimin neto të saj të pashpërndarë ndër vite (për vitet 2002 - 2006).

55. Po ashtu, ka rezultuar se në vitin 2013, konflikti i lindur mes palëve, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit me cilësinë e ortakut në shoqërinë “{***}” ShPK dhe dy ortakëve të tjerë, ka pasur si objekt pretendimet e bashkëshortit të subjektit, z. A. M., me cilësinë e paditësit për “detyrimin e të paditurit shoqëria tregtare “{***}” ShPK të kryejë pagesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë (dividend) për të gjithë periudhën e papaguar deri në ditën e ekzekutimit të vendimit”. Paditësi vetë ka pretenduar se nga momenti kur është caktuar administrator shtetasi A. R., shoqëria tregtare i ka shkëputur marrëdhëniet me ortakun A. M., duke e përjashtuar de fakto nga çdo lloj aktiviteti apo dhe shpërblimi nga shpërndarja e fitimit për gjithë vitet nga 2006 e në vazhdim.

56. Ky konflikt është zgjidhur me marrëveshje, nga e cila rezulton se ortakun A. M. ua shet kuotën e tij ortakëve të tjerë, duke realizuar përmes një kontrate shitjeje në vlerën 6.000.000 (gjashtë milionë) lekë. Gjithashtu, me marrëveshje, palët kanë rënë dakord që të njihet vlera 4.000.000 (katër milionë) lekë e dëmit të shkaktuar, e cila i është likuiduar palës cash.

57. Lidhur me përfitimimin e dëmshpërblimit, subjekti ka sqaruar se bashkëshorti e ka marrë atë cash nga ortakët e tjerë, por nuk dha asnjë informacion/shpjegim mbi detyrimin ose jo për pagimin e tatimit mbi këtë vlerë të përfituruar.

58. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” - nuk ka përcaktim të qartë për taksimin e të ardhurave nga “shpërblimi i dëmit”, por:

- a. neni 8, paragrafi/g, konsideron të ardhura personale të tatueshme: “g) Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jo-rezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”;
- b. ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 8/1, paragrafi/9, përjashton nga tatimi: “9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore”.

59. Në vijim, rezulton se përfitimi i dëmshpërblimit është bërë me marrëveshje mes ortakëve, por në vijim ai ka qenë gjithashtu pjesë e vendimit të gjykatës nr. {***}, datë 04.02.2013, i cili është i formës së prerë. Trupi gjykues vlerësoi t’i konsiderojë ato të ardhura të ligjshme.

60. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës, subjekti ka përfituruar vlerat përkatëse nëpërmjet llogarisë bankare, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues lidhur me pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës.

61. Në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 8, paragrafi f), të ardhurat nga shitja e kuotave të kapitalit apo të aksioneve janë të tatueshme. Referuar legjislacionit, e ardhura neto

duhet të tatohet me 15% (10% për vitin 2014 dhe më parë), por jo çmimi i shitjes së aksioneve apo kuotave. Për këtë qëllim, duhet të bëhet diferenca ndërmjet çmimit të shitjes së kuotës së kapitalit dhe vlerës që ka pasur kuota e kapitalit, duke parë bilancet, për të identifikuar vlerën e kapitalit, vlerën e kuotave nëse ka qenë i ndarë në kuota, më pas të llogaritet vlera e 25% të kuotës së kapitalit dhe kjo t'i zbritet çmimit të shitjes sipas kontratës të 25% të kuotës. Nëse vlera del pozitive, tatohet me 10%, referuar normës së tatimit në vitin 2013.

62. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor nëse bashkëshorti i tij kishte detyrimin për të paguar tatim mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kuotës, në vlerën përkatëse dhe nëse ishte paguar ky tatim.

63. Trupi gjykues arsyeton se, nisur nga fakti që shoqëria ka bërë ndër vite rritje të kapitalit të saj, po ashtu gjatë hetimit ka rezultuar se vlera e pasurive/aseteve të shoqërisë ka qenë e konsiderueshme dhe likuidimi i vlerës së kuotës nuk është kryer plotësisht, por vetëm një pjesë, të ardhurat e përfituara në vlerën 2.648.500 (dy milionë e gjashtëqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) lekë, deri në datën 31.12.2018, duhet të merren në konsideratë në analizën ekonomike të kryer nga Komisioni, si e ardhur e ligjshme.

64. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se të ardhurat e deklaruar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit (vitet 2002 - 2012), të përfituara nga veprimtaria tregtare e bashkëshortit, nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, mbetet e paprovuar se të ardhurat e pretenduara janë shpërndarë dhe se bashkëshorti i subjektit i ka përfitur ato.

65. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një situatë financiare negative, në vlerën totale 21.123.695 (njëzet e një milion e njëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 06.01.2020, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, në respektim të afateve dhe kërkesave ligjore¹.
6. Në ankimin e datës 06.01.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim "Kolegji"), kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe ndryshimin e vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë, pasi ka vlerësuar të nevojshëm debatin gjyqësor, duke pretenduar se Komisioni në tërësinë e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij, nuk ka zbatuar parimet e procesit të rregullt ligjor, ka bërë

¹ Vendimi i arsyetuar i Komisionit, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 19.12.2019, Institucionit të Komisionerëve Publikë në datën 18.12.2019, dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 18.12.2019, dhe ndaj tij është ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit në datën 06.01.2020, i cili u pranua nga Komisioni me vendimin nr. {***} datë 06.01.2020.

konstatimin e gabuar dhe në mënyrë jo të plotë të gjendjes faktike të pasurisë, nuk ka kryer procedurat e vlerësimit për kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe ka bërë interpretim ligjor të gabuar. Në parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, para zhvillimit të seancës gjyqësore, të dorëzuara në rrugë elektronike në datën 17.12.2021 dhe nëpërmjet shërbimit postar në datën 20.12.2021² (në vijim “parashtrimet”), subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Malo (Orhani), ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

7. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit, janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit si më poshtë.

A. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit

7.1. Procesi i kryer nga Komisioni ishte i paragjykuar dhe vendimi i paravendosur, për shkak të refuzimit të kërkesave të përsëritura, me objekt përfshirjen në proces edhe kontrollin për kriterin e figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

7.2. Vendimmarrja për kriterin e pasurisë mund të përbënte shkak shkarkimi, nëse do të ishte kumulative me atë të figurës, ose në kushtet e deklarimit të më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme.

7.3. Komisioni nuk duhet të caktonte seancën dëgjimore pa marrë në shqyrtim provat që subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur pas rezultateve të hetimit, dhe se në rezultatin përfundimtar të hetimit duhet të përfshiheshin jo vetëm provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ, por edhe ato të paraqitura pas kalimit të barrës së provës.

7.4. Trupi gjykues i Komisionit nuk përmbushte standardin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme për shkak të marrjes, administrimit, çmuarjes së provave dhe më pas dhënies së vendimit.

7.5. Trupi gjykues i Komisionit ishte dukshëm i njëanshëm pasi kishte rrëzuar në mënyrë të njëpasnjëshme kërkesa të ngritura prej tij, dhe se seanca dëgjimore ishte thjesht një formalitet për dëgjesën e publikut, por jo për të realizuar të drejtat e subjektit të rivlerësimit.

7.6. Komisioni nuk ka mbajtur të njëjtin standard objektiv vlerësimi sikurse edhe në çështje të tjera.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7.7. Komisioni në vendim kishte arritur në rezultate kontradiktore, të ndryshme me rezultatet e hetimit, duke cenuar standardin e mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit.

² Parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura njëherazi në rrugë elektronike (e-mail) dhe nëpërmjet shërbimit postar, pesë ditë para seancës gjyqësore, janë regjistruar në Kolegj përkatësisht me nr. {***} prot., datë 17.12.2021 dhe nr. {***} prot., datë 20.12.2021.

7.8. Nuk mund të jenë objekt verifikimi pasuritë e krijuara para fillimit të detyrës, apo që nuk janë krijuar nga vetë subjektet e rivlerësimit.

7.9. Të ardhurat e bashkëshortit nga dividendët e shoqërisë “{***} ShPK”, konfirmohen nga deklaratat e interesave periodike/vjetore, nga vërtetimet e shoqërisë “{***} SHPK”, ndërsa mungesa e regjistrave dhe e vendimeve të asamblesë së ortakëve të shoqërisë për shpërndarjen e fitimeve në formën e dividendit apo shtimin e kapitalit, nuk mund të vlerësohen në disfavor të subjektit të rivlerësimit.

7.10. Paligjshmëria e të ardhurave të pretenduara të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga dividendët për vitet 2002 - 2012, duhet të ishte llogaritur deri në masën e tatimit të papaguar, por jo për të gjithë shumën e të ardhurave nga dividendët.

7.11. Shuma prej 4.000.000 lekësh, si dëmshpërblim i përfituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga ortakët e shoqërisë “{***} SHPK”, duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, e përjashtuar nga tatimi.

7.12. Të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti, nga shitja e kuotave prej 25% të shoqërisë “{***} ShPK” nuk ishin të tatueshme, pasi nuk kishte asnjë akt ekspertimi, ku të përcaktohej se vlera e shitjes së këtyre kuotave kishte qenë mbi realen apo nën këtë vlerë.

7.13. Rezultati negativ i arritur në analizën financiare të Komisionit është tërësisht i palogjikshëm dhe në mungesë totale të një metodologjie, duke renditur si shkaqe se në vitet 1993 - 1998 ka pasur të ardhura nga blegtoria, të ardhurat për periudhën 1995 - 2002 janë më të larta nga sa Komisioni i ka llogaritur, nuk janë përfshirë të ardhurat e përfituara nga lejet e lindjes në vitet 1996, 1997 dhe 2000, dhe nuk janë konsideruar si të ligjshme të ardhurat e përfituara nga qiraja e lokalit në vitin 2015.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

8. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 206, datë 07.11.2019, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).

8.1. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur ndaj vendimit të Komisionit ushtrohet ankim nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret

e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

9. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.
10. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit, paraqiti disa akte dhe dokumente në cilësinë e provave të reja, për të cilat trupi gjykues vlerëson se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, si dhe refuzohen të merren si prova bazuar në nenin 49, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

10.1. Përkatësisht *kundërshtimet për gjetjet e hetimit administrativ datë 09.09.2019*, është një akt i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Komision. Për këtë arsye, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016³, refuzohet marrja në cilësinë e provës nga Kolegji. Sa i përket aktit me titull *“Informacioni⁴ për sqarimin e plotësimit të formularëve për deklarimin e pasurisë për vitet 2005 – 2006”⁵ dhe shkresës nr. {***} prot., datë 13.09.2019, të Drejtorisë Rajonale Korçë, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore⁶*, janë dokumente që referojnë në fakte të njohura nga Komisioni. Për këto arsye, këto akte dhe dokumente përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre në zgjidhjen e çështjes, dhe refuzohen të merren si prova bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

10.2. Për sa i përket mandatpagesës, datë 29.03.2011, së {***}⁷, të paraqitur me parashtrimet, trupi gjykues vlerëson se ky dokument nuk plotëson kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 i ndryshuar, sipas të cilave deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, dhe gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se ky dokument referon në fakte të njohura nga Komisioni⁸, dhe për këto arsye përjashtohet nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së saj në zgjidhjen e çështjes.

10.3. Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.09.2019, të Drejtorisë Rajonale Korçë, pranë Insitututit të Sigurimeve Shoqërore, subjekti i rivlerësimit synon të vërtetojë se ka përfituar të ardhura nga

³ Neni 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit [...]”.

⁴ Pa datë.

⁵ Referon në vërtetimet e shoqërisë “{***} ShPK”.

⁶ Fakt i njohur nga Komisioni sipas zërit “e ardhur nga lejet e lindjeve SR (vitet 1996, 1997 dhe 2000)” të analizës financiare 2003 - 2016, të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁷ Fotokopje.

⁸ Fakt i njohur nga Komisioni sipas paragrafit 49.1 të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

leja e lindjes për vitet 1996, 1997 dhe 2000⁹. Në lidhje me këtë rrethanë, Komisioni ka vlerësuar se pagesa për lejen e lindjes për vitet 1996, 1997 dhe 2000, ishte në masën prej 232.650 lekësh¹⁰, ndaj trupi gjykues çmon se është e panevojshme marrja e kësaj shkrese në cilësinë e provës dhe, për këtë arsye, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016¹¹, refuzohet marrja në cilësinë e provës nga Kolegji.

11. Kolegji arriti në përfundimin se, në referencë të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, debati gjyqësor nuk ishte i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendim nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

12. Në lidhje me shkakun e ankimit se procesi i kryer nga Komisioni ishte i paragjykuar dhe vendimi i paravendosur, për shkak të refuzimit të kërkesave të përsëritura për kryerjen e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 2, fjalia e fundit e ligjit nr. 84/2016¹², vlerëson se vendimi mund të merret edhe bazuar në një prej kritereve të rivlerësimit, sikurse në rastin konkret për kriterin e pasurisë¹³ dhe, për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtat e tij.
13. Në lidhje me shkakun e ankimit se vendimmarrja për kriterin e pasurisë mund të përbënte shkak shkarkimi, nëse do të ishte kumulative me atë të figurës, ose të deklaramit të më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme, trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit¹⁴, vlerëson se kriteret e vlerësimit të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale janë të pavarura¹⁵ nga njëra-tjetra.

13.1. Secila prej pjesëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, *pavarësi* e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

⁹ Por pa mundur të përcaktojë shumën që u korrespondon të ardhurave përkatëse.

¹⁰ Shih analizën financiare 2003 - 2016, në f. 22 të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, përkatësisht zërin: “të ardhura nga lejet e lindjeve SR (vitet 1996, 1997 dhe 2000)”, në shumën prej 232.650 lekësh.

¹¹ Neni 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] a) marrja e provës duket se është e panevojshme; [...]”.

¹² Neni, 4, pika 2, fjalia e fundit e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

¹³ Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 1/2019 (JR), nr. 12/2019 (JR), nr. 15/2019 (JR) dhe nr. 29/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁴ Vendimi nr. 29/2020 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁵ Vendimi nr. 19/2019 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Më konkretisht, pika 1 e nenit 61 përcakton si shkelje *deklarimin më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të*, pika 2 përcakton si shkelje *problemet serioze që lidhen me ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar*, çka ndikon në kontrollin dhe konkluzionet për kriterin e figurës, pika 3 përcakton si shkelje *pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të figurës dhe pamjaftueshmërinë për kriterin e kontrollit të pasurisë*, pika 4 konkludon për *përshtatshmërinë për shkak të nivelit të aftësive profesionale*, dhe pika 5 përcakton si shkelje *cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*. Sikurse rezulton nga ky zberthim, pikat 3 dhe 4 të nenit D të Kushtetutës janë pasqyruar në parashikimet 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e pasurisë. Të dyja këto raste rrjedhin nga situata specifike të veçanta dhe nuk mund të konsiderohet se zbatohen në mënyrë kumulative.

13.2. Një situatë e tillë procedurale çmohet nga trupi gjykues se nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupës gjyqese të Komisionit apo paracaktim të vendimit¹⁶, në kushtet kur faktet dhe rrethanat për kriterin e vlerësimit të pasurisë kanë rezultuar përcaktuese dhe të mjaftueshme për të mbështetur vendimin.

14. Në lidhje me shkakun e ankimit se Komisioni nuk duhet të caktonte seancën dëgjimore pa shqyrtuar dhe përfshirë në raportin përfundimtar provat që kishte paraqitur subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit, në përputhje me jurisprudencën e Kolegjit¹⁷, trupi gjykues vlerëson se, pas ushtrimit të barrës së provës, Komisioni, vlerësimin për çdo provë, akt/dokument dhe shpjegim, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, e kryen në tërësi, nëpërmjet vendimit përfundimtar, siç shtjellohet në pikat 27, 52-65 të vendimit nr. 206 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

14.1. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtat e tij.

15. Në lidhje me shkakun e ankimit se trupi gjykues i Komisionit nuk përmbushte standardin e gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për shkak të marrjes, administrimit, çmuarjes së provave dhe më pas dhënies së vendimit, trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNJ”)¹⁸, vlerëson se vetëm fakti i thjeshtë i ushtrimit të kompetencave ligjore nga trupi gjykues i Komisionit, duke hetuar çështjen, duke arritur në rezultate paraprake dhe duke marrë në vijim vendim në përfundim të procesit, nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar objektivisht pretendimin mbi paanësinë e anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit.

¹⁶ Vendimi nr. 34/2021 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁷ Vendimet nr. 1/2019 (JR), nr. 2/2019 (JR), nr. 5/2019 (JR), nr. 1/2020 (JR), nr. 2/2020 (JR), nr. 3/2020 (JR), nr. 6/2020 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR), nr. 22/2021 (JR), nr. 26/2021 (JR), nr. 28/2021 (JR) dhe nr. 31/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁸ Vendimi Xh. kundër Shqipërisë, paragrafi 308.

16. Në lidhje me shkakun e ankimit se trupi gjykues i Komisionit ishte dukshëm i njëanshëm pasi kishte rrëzuar në mënyrë të njëpasnjëshme kërkesat e ngritura prej saj¹⁹, trupi gjykues, vëren se kërkesën e datës 31.07.2019 të subjektit të rivlerësimit, znj. Brunilda Malo, me objekt shtyrjen e afatit për të paraqitur shpjegime dhe prova²⁰, trupi gjykues i Komisionit e ka rrëzuar me vendimin e ndërmjetëm, datë 31.07.2019, për arsye se procesi i rivlerësimit është i pavarur nga ushtrimi i funksionit si gjyqtare, dhe marrja e lejes vjetore prej saj, nuk është fakt pengues që subjekti i rivlerësimit të ushtronte të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga procesi i rivlerësimit.

16.1. Gjithashtu, në përputhje me parimin e objektivitetit, trupi gjykues i Komisionit ka marrë vendimin e datës 23.08.2019, nëpërmjet të cilit ka pranuar kërkesën e datës 22.08.2019 të subjektit të rivlerësimit, me objekt shtyrjen e afatit për të dhënë shpjegime dhe paraqitur prova, kësaj radhe për arsye shëndetësore, duke e konsideruar si shkak objektiv që përlligj shtyrjen e afatit për këtë fakt pengues për subjektin e rivlerësimit, që të ushtronte të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga procesi i rivlerësimit.

16.2. Për sa i përket rrëzimit të kërkesës, datë 09.09.2019, së subjektit të rivlerësimit, me objekt riçeljen e hetimit edhe për kriteret e figurës dhe të profesionalizimit, me vendimin e ndërmjetëm, datë 01.10.2019, dhe të kërkesës me të njëjtin objekt në seancën dëgjimore, datë 03.10.2019, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk kishte arritur të vërtetonte të kundërtën e vlerësimit paraprak të Komisionit²¹, për më tepër vetëm fakti i thjeshtë i marrjes së vendimeve të ndërmjetme nga Komisioni pas rezultateve të hetimit, nuk ngrihet në nivelin e dyshimit të arsyeshëm për njëanshmëri të trupit gjykues të Komisionit.

16.3. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në kërkesën e datës 31.07.2019, nuk kishte paraqitur shkaqe objektive lidhur me shtyrjen e afatit për të paraqitur prova dhe shpjegime dhe se procesi i rivlerësimit mbi një kriter bazohet, si më sipër arsyetuar, në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këto arsye, Komisioni nuk ka cenuar të drejtat e subjektit të rivlerësimit nëpërmjet vendimeve të ndërmjetme.

17. Në lidhje me shkakun e ankimit se Komisioni nuk ka mbajtur të njëjtin standard objektiv vlerësimi sikurse edhe në çështje të tjera, trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi, në kushtet kur çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale duke u bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni²², ndaj për këtë arsye trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtat e tij mbi bazën e këtij shkak.

¹⁹ Duke e bërë seancën dëgjimore thjesht një formalitet për dëgjesën e publikut, por jo për të realizuar të drejtat e subjektit të rivlerësimit.

²⁰ Për shkak se subjekti i rivlerësimit ishte me leje vjetore.

²¹ Se provat e grumbulluara për kriterin e pasurisë ishin të mjaftueshme për të mbështetur vendimin.

²² Vendimet nr. 20/2021 (JR) dhe nr. 25/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

18. Në lidhje me shkakun e ankimit në të cilin pretendohet se Komisioni në vendim kishte arritur në rezultate të ndryshme lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme, në krahasim me rezultatet e hetimit, trupi gjykues vëren se Komisionit, në analizën financiare të kryer para kalimit të barrës së provës, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera i ka rezultuar në diferencat e pajustificuara me burime të ligjshme, për periudhën 2003 - 2016, në vlerën prej (-) 20.886.985 lekësh, para vitit 2003 në vlerën prej (-) 3.425.115 lekësh, për periudhën 2017 - 2018 në vlerën prej (-) 4.125.576 lekësh, ndërsa në vendim, Komisioni ka arritur në përfundimin se diferenca ishte në vlerën prej (-) 21.123.695 lekësh²³.

18.1. Në mënyrë të detajuar, sipas analizës financiare të kryer në Komision për vitet 2003 - 2016²⁴, mungesat e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera, kanë rezultuar përkatësisht: në vitin 2005, në vlerën prej (-) 1.881.849 lekësh; në vitin 2006, në vlerën prej (-) 1.643.475 lekësh; në vitin 2007, në vlerën prej (-) 2.402.096 lekësh; në vitin 2008, në vlerën prej (-) 500.335 lekësh; në vitin 2009, në vlerën prej (-) 3.000.709 lekësh; në vitin 2010, në vlerën prej (-) 550.056 lekësh; në vitin 2011, në vlerën prej (-) 360.118 lekësh; në vitin 2012, në vlerën prej (-) 2.924.795 lekësh; në vitin 2013, në vlerën prej (-) 905.653 lekësh; në vitin 2014, në vlerën prej (-) 1.084.260 lekësh; në vitin 2015, në vlerën prej (-) 2.514.194 lekë dhe; në vitin 2016, në vlerën prej (-) 1.746.512 lekësh. Në total, me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në diferencën prej (-) 19.514.051 lekësh.

18.2. Në funksion të kontrollit të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë Fondi i Investimeve në {***}, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në formularin e deklarimit të pasurisë për rivlerësimin, shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 (në vijim “deklarata *vetting*”), e cila ka pasur si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në Ersekë, të blerë pas tërheqjes së depozitës në {***}, sipas analizës financiare të kryer për të vlerësuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e depozitës prej 5.408.181 lekësh në {***} në vitin 2002, Komisionit i ka rezultuar mungesa e burimeve financiare të ligjshme për justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 1.200.525 lekësh. Në total, mungesa e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për periudhat para vitit 2003 dhe deri në vitin 2016, sipas analizës financiare të kryer në Komision ishte në diferencën prej (-) 20.714.576 lekësh.

18.3. Për sa i përket analizës financiare sipas rezultateve të hetimit datë 29.07.2019, mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë për periudhën para 2003 - 2016, Komisionit i ka rezultuar në diferencën prej (-) 20.886.985 lekësh, duke i shtuar kësaj vlere edhe diferencën e pajustificuar me burime të ligjshme për periudhën para vitit 2003, në vlerën prej (-) 3.425.115

²³ F. 20 dhe f. 24 të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

²⁴ F. 20 e vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

lekësh, dhe duke i shtuar kësaj vlere edhe diferencën e pajustificuar me burime të ligjshme për periudhën 2017 - 2018, diferenca e pajustificuar me burime të ligjshme arrinte në vlerën prej (-) 4.125.576 lekësh.

18.4. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në ankim i referohet diferencës së pajustificuar me burime të ligjshme sipas rezultateve të hetimit datë 29.07.2019, në vlerën prej (-) 20.886.985 lekësh, vlerë e cila është rishikuar nga Komisioni në vendimin përfundimtar, duke konsideruar në analizën financiare si të ligjshme të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti nga dëmshpërblimi prej 4.000.000 lekësh²⁵, të ardhurat prej 2.648.500 lekësh²⁶ nga shitja e kuotës prej 25% të bashkëshortit në shoqërinë “{***} ShPK”, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “{***}” në vitin 2006²⁷, në shumën prej 3.000 eurosh (e konvertuar në 371.109 lekë), si dhe përfshirjen në analizë financiare të gjendjes së llogarisë së vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj. A. M., në “{***}” Londër, Mbretëria e Bashkuar, me vlerë 13.000 GBP²⁸.

18.5. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk janë kontradiktore përfundimet në analizën financiare që i përket periudhës 2003 - 2016²⁹, por ato janë pasqyrim i vlerësimeve paraprake të Komisionit dhe i ndryshimeve që analiza financiare ka pësuar pasi i kishte kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit.

18.6. Trupi gjykues vlerëson se analiza financiare sipas rezultateve të hetimit datë 29.07.2019, nuk është përfundimtare dhe as përcaktuese për pasojën, por ka për qëllim për të vlerësuar nëse provat e grumbulluara janë të mjaftueshme për të arritur në përfundime për Komisionin sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në këtë vlerësim, trupi gjykues çmon se analiza financiare është një garanci që i jepet subjektit të rivlerësimit për të debatuar mbi tërësinë e provave, kundërshtimin e provave që janë marrë apo për t’u marrë prova të reja, përfshirë edhe kundërshtimin e metodologjisë së përgatitjes së analizës paraprake financiare, ndaj për këtë arsye pretendimi i subjektit të rivlerësimit se konkluzionet e Komisionit janë kontradiktore, nuk është i mbështetur.

18.7. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se nuk është i mbështetur as pretendimi i subjektit të rivlerësimit se është cenuar standardi i mospërkeqësimit të situatës së subjektit të rivlerësimit³⁰, për arsye se, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit³¹, standardi i mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit mund të gjejë zbatim në ankim, por jo në procedurat e shqyrtimit të çështjes në Komision.

²⁵ Sipas vendimit nr. {***}, datë 04.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (në vijim “GjRrGjK”).

²⁶ Në analizën financiare për periudhën 2003 - 2016, për vitin 2013 është konsideruar shuma prej 150.000 lekësh; për vitin 2014, shuma prej 500.000 lekësh dhe për vitin 2015, shuma prej 500.000 lekë; në total në shumën prej 1.150.000 lekësh; ndërsa në vitin 2017 është konsideruar shuma prej 499.500 lekësh dhe; për vitin 2018, shuma prej 999.000 lekësh.

²⁷ Paragrafët 37.3 dhe 37.5 të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

²⁸ Paragrafi 48.1 i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

²⁹ Duke përjashtuar analizën financiare për periudhën 2017 - 2018, për të cilën kompetente është ILDKPKI-ja.

³⁰ Mbi bazën e të cilit subjekti i rivlerësimit mbështet argumentin e qenies kontradiktore të vlerave të diferencave të pajustificuara me burime të ligjshme sipas rezultateve të hetimit në krahasim me vendimin në përfundim të procesit.

³¹ Vendimi nr. 25/2020 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

18.8. Në lidhje me shkakun e ankimit se nuk mund të jenë objekt verifikimi pasuritë e krijuara para fillimit të detyrës, apo që nuk janë krijuar nga vetë subjektet e rivlerësimit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit para vitit 2003, kishte krijuar pasuri, likuiditete në bankë në vlerën prej 5.408.181 lekësh³², e cila është përdorur si burim për krijimin e pasurisë apartament me sip. 80,6 m² në Ersekë, e cila më pas ka shërbyer për krijimin e depozitës në Fondin e Investimeve në {***}, deklaruar në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, ndërsa nga analiza financiare për periudhën 2017 - 2018, Komisionit i rezultoi se në vitin 2017, subjekti i rivlerësimit kishte mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera në diferencën prej (-) 409.119 lekësh, ndërsa në vitin 2018 kishte të pajustificuar me burime të ligjshme dhurimin prej 14.000 GBP nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. S. O..

18.9. Sipas parashikimeve të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i vlerësimit për kriterin e pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, *pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar”) që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, formulari i deklaratës *vetting*, shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, në faqen 5, përcakton detyrimin për deklarimin e të gjitha pasurive të akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.*

18.10. Trupi gjykues vlerëson se në zbatim të legjislacionit më sipër, objekt kontrolli për kriterin e pasurisë, janë pasuritë për të cilat subjekti i rivlerësimit mbarte detyrimin për t’i deklaruar në deklaratën *vetting* dhe që janë relevante për çështjet e rivlerësimit³³. Për sa u përket pasurive të krijuara para fillimit të detyrës, bazuar në pikën 7 të udhëzimit, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ishte mbartës i detyrimit që për çdo pasuri objekt kontrolli, të deklaronte edhe burimin, në momentin e krijimit të pasurisë përkatëse dhe, për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se pasuritë e krijuara para kësaj periudhe kanë *relevancë* me procesin e rivlerësimit, pasi ato kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*.

18.11. Për këto arsye, pasuritë e krijuara para fillimit të detyrës janë objekt verifikimi sepse sjellin informacion relevant për verifikimin e mundësisë financiare kur kanë shërbyer si burim i pasurive

³² Vërtetimi nr. {***} prot., datë 14.06.2009, i {***}, lidhur me depozitën e çelur në vitin 2002, me vlerë 5.408.181 lekë.

³³ Vendimet nr. 8/2021 (JR), nr. 31/2021 (JR) dhe nr. 37/2021 (JR).

të deklaruara në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, objekt kontrolli në kuadër të këtij procesi, por nga ana tjetër nuk kanë relevancë pasuritë e krijuara pas deklaratës *vetting*. Bazuar në sa u arsyetua më sipër, trupi gjykues konkludon se nuk mund t'i nënshtrohet kontrollit ligjshmëria e të ardhurave për periudhën 2017 – 2018, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së burimeve për pasuritë likuiditete të personave të lidhur të subjektit të rivlerësimit dhe shpenzimet e kryera gjatë kësaj periudhe, sikurse dhe dhurimi prej 14.000 GBP nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. S. O..

19. Në lidhje me shkakun e ankimit se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga dividendët e shoqërisë “{***} ShPK”, konfirmohen nga deklaratat e interesave periodikë/vjetorë, nga vërtetimi i datës 17.09.2007, si dhe shkresa kthim përgjigje e shoqërisë “{***} ShPK”, datë 02.09.2019, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat si ortak i vetëm për vitet 2002 - 2004, më pas si ortak me 33% për vitet 2005 - 2006, dhe nga viti 2006 - 2012 si ortak me 25% në shoqërinë “{***} ShPK”, në vlerën prej 24.161.748 lekësh, ndërsa në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë ka deklaruar të ardhura të bashkëshortit si ortak i shoqërisë “{***} ShPK”, pa përfshirë pagat, në shumën totale prej 21.140.000 lekësh³⁴.

19.1. Për sa u përket të ardhurave nga dividendët, të pretenduara si të krijuara nga bashkëshorti, në cilësinë e ortakut të shoqërisë “{***} ShPK” në vitet 2002 - 2012, Komisioni ka vlerësuar se ato nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke arsyetuar se mbetet e paprovuar se shoqëria “{***} ShPK”, kishte shpërndarë dividend dhe se bashkëshorti i saj i kishte përfituar këto të ardhura pas pagimit të tatimit, sipas ligjit.

19.2. Trupi gjykues vëren se, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 06.02.2015, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë (në vijim “DRTK”), ka vërtetuar se fitimet neto të shoqërisë “{***} ShPK” për vitet 2002 - 2012, ishin në shumën prej 40.338.677 lekësh, pa specifikuar lidhur me shpërndarjen e dividendëve apo pagesën e tatimit për shpërndarjen e dividendëve.

19.3. Ndërsa, nga shkresa nr. {***} prot., datë 17.07.2017, e DRTK-së, rezulton se shoqëria “{***} ShPK”, në të cilën bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ishte ortak me 25% të kuotave, kishte realizuar shpërndarje dividendi vetëm për dy periudha tatimore, përkatësisht për vitin 2009, në shumën prej 200.000 lekësh dhe për vitin 2010, në shumën prej 200.000 lekësh.

³⁴ Si total i deklaramit në: vitin 2003 prej 6.000.000 lekësh, me përshkrimin “Të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortit, president ligjor i firmës {***} ShPK”, në vitin 2004 prej 9.500.000 lekësh, me përshkrimin “A. M., fitim nga biznesi si drejtues ligjor i firmës “{***} ShPK”, në vitet 2005 dhe 2006 e 2007 nuk ka deklaruar duke u shprehur “nuk është hartuar/mbyllur ende bilanci i firmës”, sipas formatit të deklaratës së interesave periodikë/vjetorë 2008, më datë 21.04.2008, deklararon të ardhura prej 3.000.000 lekësh në vitin 2005 dhe 300.000 lekësh në vitin 2006, e më tej ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti privat i shoqërisë {***} ShPK, 25% në cilësinë e ortakut, në vitin 2008, prej 400.000 lekësh, në vitin 2009 prej 1.100.000 lekësh, në vitin 2010 prej 690.000 lekësh, në vitin 2011 prej 100.000 lekësh, dhe në vitin 2012 prej 50.000 lekësh.

19.4. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, së bashku me vërtetimin e datës 02.09.2019 të shoqërisë “{***} ShPK”³⁵, ka paraqitur edhe pjesë të pasqyrave financiare, nga të cilat në vitet 2004 - 2005, nuk rezultonte shpërndarje dividendi dhe i pacaktuar fitimi i kësaj shoqërie³⁶, ndërsa në vitet 2006, 2007, 2009, 2011 dhe 2012, rezultonte fitimi neto i kësaj shoqërie, por jo shpërndarja e këtij fitimi në formën e dividendit³⁷.

19.5. Nga akti i ekspertimit, datë 24.06.2005, të ekspertit kontabël të autorizuar Q. K., të depozituar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën *vetting*, rezulton se fitimet e mbartura të periudhës 1997 - 2004 të shoqërisë “{***} ShPK”, në shumën prej 9.563.456 lekësh, ishin përdorur për rritjen e kapitalit, sikurse rezulton edhe nga të dhënat e ekstraktit historik me NUIS {***}, që është burim informacioni i hapur për publikun, i publikuar në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit³⁸.

19.6. Në kushtet kur fitimi i mbartur i shoqërisë “{***} ShPK” në vitin 2004 rezulton më i lartë në krahasim me vitet 2002 - 2003³⁹, përkatësisht në shumën prej 2.012.438 lekësh dhe 6.067.687 lekësh, në mungesë të vendimeve të asamblesë së shoqërisë “{***} ShPK”, lidhur me shpërndarjen e dividendit, trupi gjykues, bazuar në nenin 49, pika 1, shkronja “b” dhe pika 4 e ligjit nr. 84/2016, krijon bindjen se nuk ka pasur shpërndarje dividendi në vitet 1997 - 2004, dhe se fitimi i realizuar nga shoqëria “{***} ShPK” në këtë periudhë është destinuar për rritjen e kapitalit.

19.6.1. Edhe në rastin e një analize të parashtrimit se, për sa kohë që nuk ka një situatë financiare përpara vitit 2002 për shoqërinë “{***} ShPK”, aktivitetin edhe fitimet e saj, apo vendimarrje për vlerat e sakta të përdorura për shtimin e kapitalit për periudhën 1997 - 2002, nuk mund të arrihet në konkluzionin se të gjitha fitimet janë përdorur për shtimin e kapitalit, por vetëm pjesërisht, trupi gjykues vëren se fitimi i vitit 2002 i shoqërisë “{***} ShPK” ka qenë 2.012.438 lekë dhe në vitin 2003 ka qenë 6.067.687 lekë, në total në vlerën prej 8.080.125 lekësh⁴⁰. Kjo vlerë është më e vogël se fitimet e mbartura që sipas akt-ekspertizës së datës 24.06.2005, të ekspertit kontabël Q. K., ishin në shumën 9.563.456 lekë në vitin 2004. Duke qenë se kjo vlerë është më e vogël se fitimet e mbartura në shumën prej 9.563.456 lekësh në vitin 2004, ka indicie se mund të ketë pasur fitim të shpërndarë në mënyrë të pjesshme shoqërisë “{***} ShPK”, por e pamjaftueshme për t’u konsideruar si të ardhura të ligjshme në kushtet e mungesës së dokumenteve

³⁵ Shoqëria “{***} ShPK” vërteton se në vitin 2004 fitimi duhet të jetë përfituruar prej bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, asokohe ortak i vetëm, në vlerën prej 9.097.066 lekësh, në vitet 2005 - 2007 konfirmon se fitimet neto që kishin mbetur u ishin ndarë ortakëve, dhe për vitet 2009, 2011 - 2012, fitimi neto u ishte ndarë ortakëve, dhe shoqëria “{***} ShPK” vërteton se nuk është mbajtur regjistër dhe vendimet për ndarjen e fitimit janë marrë në marrëveshje me ortakët mbas miratimit të bilanceve.

³⁶ Për vitet 2004 dhe 2005 nuk rezulton të jetë deklaruar vlerë në seksionin “5 Dividentë” në pjesën e pasqyrave financiare “Caktimi i fitimit”, por fitimi i vitit rezulton si “Fitimi i pacaktuar”.

³⁷ Në vitet 2006, 2007, 2009, 2011 dhe 2012, sipas pjesës së pasqyrave financiare “Të ardhurat” dhe/ose “Shpenzimet” apo “Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve” konfirmon fitimin neto për vitin, por jo destinimin e fitimit të vitit.

³⁸ <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>.

³⁹ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 06.02.2015, të DRTK-së.

⁴⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 06.02.2015, e DRTK-së.

që dëshmojnë shpërndarjen e dividendit, sikurse edhe të pagimit të detyrimeve tatimore, sipas legjislacionit në fuqi⁴¹.

19.7. Për sa i përket pretendimit se të ardhurat nga dividendët konfirmohen nëpërmjet deklarimeve në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë, trupi gjykues vlerëson ato mund të përdoren si provë në përputhje me përcaktimet e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016⁴², por duke i vlerësuar në harmoni dhe pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016⁴³.

19.8. Në jurisprudencën⁴⁴ e Kolegjit të mbajtur në raste të ngjashme, kontrolli i deklaratës *vetting* dhe krahasimi i saj me deklaratimet e interesave privatë periodikë/vjetorë, i shërben Komisionit dhe Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, pra mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij.

19.9. Trupi gjykues vëren se DRTK-ja⁴⁵ nuk ka konfirmuar shpërndarjen e fitimeve të shoqërisë “{***} ShPK”, ndërkohë që rezultojnë të vërtetuar mbartja e fitimeve të kësaj shoqërie për periudhën 1997 - 2004⁴⁶, nuk rezultojnë pasqyrim i shpërndarjes së dividendit nga pasqyrat financiare të viteve 2005, 2006, 2007, 2008, 2011 dhe 2012, nuk rezultojnë pagimi i tatimit mbi fitimin mbi dividendët e shpërndarë në vitet 2009 dhe 2010 dhe, për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se deklaratimet në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, rrjedhimisht, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për t’i konsideruar ato si të ardhura të ligjshme, është i pambështetur.

19.10. Për sa u përket vërtetimeve, datë 17.09.2007 dhe datë 02.09.2009, të lëshuara nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “{***} ShPK”, sipas parashikimeve të nenit 215 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për shoqëritë tregtare” (në vijim “ligji nr. 7638/1992”)⁴⁷, dhe nenit 81, pika 3,

⁴¹ Neni 8, pika 1, shkronja b e ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar.

⁴² Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit”.

⁴³ Neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 4. Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.

⁴⁴ Vendimet nr. 6/2018 (JR), nr. 7/2018 (JR), nr. 8/2018 (JR), nr. 9/2018 (JR), nr. 10/2018 (JR), nr. 12/2018 (JR), nr. 9/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR), nr. 19/2019 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁴⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 27.09.2009, e DRTK-së.

⁴⁶ Sipas aktit të ekspertit kontabël Q. K., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën *vetting*.

⁴⁷ Neni 215 i ligjit nr. 7638/1992 parashikonte se: “Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidencimit të ekzistencës së shumave që do të shpërndahen, asambleja përcakton pjesën që u takon aksionarëve në formë dividendësh. Çdo dividend i shpërndarë, duke shkelur këto rregulla, përbën një dividend fiktiv. Megjithatë nuk përbëjnë dividend fiktiv paradhëniet, vlera e të cilave ka rrjedhur nga vitet financiare të mbyllura ose në vazhdim, të cilat janë derdhur përpara se të jenë miratuar llogaritë e këtyre viteve financiare, me kusht që: 1. Shoqëria, veç rezervës së domosdoshme, të ketë në dispozicion rezerva me një shumë të paktën të njëjtë me paradhëniet e shpërndara ose që një raport vërtetimi i bërë nga një ekspert kontabël i autorizuar të bëjë të njohur fitime neto më të mëdha se shumat e paradhënies; 2.

shkronja “b” e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (në vijim “ligji nr. 9901/2007”), shpërndarja e dividendit është kompetencë e asamblesë së ortakëve të shoqërisë. Për këtë arsye, këto vërtetime janë të natyrës deklarative, ndaj ato nuk janë prova të besueshme në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

19.11. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se mungesa e regjistrave dhe e vendimeve të asamblesë së ortakëve për shpërndarjen e fitimeve në formën e dividendit apo shtimin e kapitalit në shoqërinë ku personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, kishte qenë ortak, nuk mund të vlerësohen në disfavor të saj, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se bazuar në parashikimet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte barrën e provës për të vërtetuar se ishte në pamundësi objektive për të disponuar këto dokumente, apo se ato ishin zhdukur, kishin humbur, apo nuk mund të bëheshin apo të merreshin në rrugë tjetër⁴⁸.

19.12. Në lidhje me pretendimin se paligjshmëria e të ardhurave të pretenduara nga dividendët e shoqërisë “{***} ShPK” për vitet 2002 - 2012, duhet të ishte llogaritur deri në masën e tatimit të papaguar, por jo për të gjithë shumën e të ardhurave nga dividendët, bazuar në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës⁴⁹, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, si të ardhura të ligjshme duhen konsideruar vetëm të ardhurat të cilat plotësojnë në mënyrë kumulative këto dy kritere, që janë deklaruar dhe për të cilat vërtetohet pagimi i detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi⁵⁰. Trupi gjykues vlerëson se është i pambështetur pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pasuri e ligjshme është ajo që do të ngelej nëse tatimi do të ishte paguar, për arsye se kushti i pagimit të detyrimeve tatimore është kumulativ.

19.13. Bazuar në arsyetimin dhe vlerësimet e mësipërme, trupi gjykues i gjen të pambështetura pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të konsideruar si të ligjshme të ardhurat e bashkëshortit nga dividendi i shoqërisë “{***} ShPK”.

- 20.** Në lidhje me pretendimin se shuma prej 4.000.000 lekësh, si dëmshpërblim, nga ortakët e shoqërisë “{***} ShPK”, duhet të konsiderohet si e ardhur e ligjshme, e përjashtuar nga tatimi, trupi gjykues vëren se përfitimi i kësaj shume rezulton nga *vendimi nr. {***}, datë 07.01.2013, i asamblesë së shoqërisë “{***} ShPK”*⁵¹, nga marrëveshja datë 07.01.2013, ndërmjet z. A. M., z.

Shpërndarja e paradhënieve të vendoset nga drejtoria ose nga administratorët, që përcaktojnë shumën dhe datën e kthimit”.

⁴⁸ Neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...]”.

⁴⁹ I cili parashikon: “[...] Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore [...]”.

⁵⁰ Vendimet nr. 6/2019 (JR) dhe nr. 23/2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁵¹ Për miratimin e tjetërsimit të 25 % të kuotave që zotëronte ortaku z. A. M., në favor të ortakëve z. Gj. Ç. dhe z. A. R.i.

*Gj. Ç. dhe z. A. R.*⁵², nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.01.2013, e ortakëve z. A. M., z. Gj. Ç. dhe z. A. R., si dhe nga pjesa arsyetuese e vendimit nr. {***}, datë 04.02.2013, të GjRGjK-së.

20.1. Për sa i përket mospagimit të tatimit mbi të ardhurën prej 4.000.000 lekësh, me burim shpërblimin e dëmit nga ortakët e shoqërisë “{***} ShPK”, subjekti i rivlerësimit për pretendimin e tij se kjo e ardhur ishte e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat, i referohet nenit 8/1, pika 9 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998, i ndryshuar”).

20.2. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e kësaj shume nga tatimi mbi të ardhurat është i pambështetur në ligj, për arsye se nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 04.02.2013, të GjRGjK-së, gjykata nuk ka zgjidhur në themel çështjen e shitblerjes së kuotave dhe shpërblimit të dëmit për mosshpërndarje dividendi. Objekti i kërkesëpadisë së depozituar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ishte likuidimi i pagesës për shitjen e kuotave, pagesa e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë (dividentin) për të gjithë periudhën e papaguar deri në ekzekutimin e vendimit, si dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga largimi i ortakut në mënyrë solidarë nga shoqëria “{***} ShPK”. Trupi gjykues vlerëson se përfshirja në objektin e padisë e detyrimit për pagesën e dividentit për të gjithë periudhën deri në ekzekutimin e vendimit, provon se, ndryshe nga sa është përcjellë nëpërmjet vërtetimeve të lëshuara nga ortakët e shoqërisë në kuadër të këtij procesi, shoqëria, pavarësisht fitimit të realizuar, nuk ka shpërndarë dividend për ortakët e saj, përfshirë edhe për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, pjesa arsyetuese e këtij vendimi⁵³ që lidhet me shkaktimin e dëmit z. A. M. nga ortakët e tjerë të shoqërisë “{***} ShPK”, z. Gj. Ç. dhe z. A. R., nuk shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit gjyqësor⁵⁴. Z. A. M., dëmshpërblimin prej 4.000.000 lekësh, që përfaqësonte dëmin e shkaktuar nga mospagimi në kohë të dividendit të shoqërisë “{***} ShPK”, nuk rezulton që ta ketë përfituar nëpërmjet një vendimi gjyqësor të formës së prerë, në kuptim të nenit 8/1, pika 9 e ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, por nëpërmjet marrëveshjes jashtëgjyqësore të ortakëve dhe, si pasojë, nuk ishte e ardhur e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin, sipas parashikimeve ligjore.

20.3. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues vëren se të ardhurat prej 4.000.000 lekësh janë marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer në Komision⁵⁵ dhe, për këtë arsye, në përputhje me standardin e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit⁵⁶, trupi gjykues vlerëson se diferenca e pajustificuar me burime të ligjshme duhet të ngelet në vlerën e llogaritur në analizën financiare të kryer në Komision.

⁵² E lidhur në përputhje me ligjin nr. {***}, datë 24.02.2011, nëpërmjet Qendrës së Ndërmjetësimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

⁵³ Faqja 4, paragrafi i tretë i vendimit nr. {***}, datë 04.02.2013, i GjRGjK-së.

⁵⁴ Ratio decidendi.

⁵⁵ Paragrafi 50.2 i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁵⁶ Vendimi nr. 25/2020 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

21. Në lidhje me shkakun e ankimit se të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti, nga shitja e kuotave prej 25% të shoqërisë “{***} ShPK”, nuk ishin të tatueshme, pasi nuk kishte asnjë akt ekspertimi ku të përcaktohej se vlera e shitjes së këtyre kuotave të kishte qenë mbi realen apo nën këtë vlerë, trupi gjykues vëren se bashkëshorti ka përfituar të ardhurat prej 2.648.500 lekësh, përkatësisht vlerën prej 1.150.000 lekësh deri në datën 31.12.2016 dhe vlerën prej 1.498.500 lekësh deri në datën 31.12.2018, për të cilat nuk rezulton pagimi i tatimit.

21.1. Neni 8, pika 1, shkronja “f” e ligjit nr. 8438/1998 i ndryshuar, përcakton si të tatueshme të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave që një ortak i shet një personi tjetër⁵⁷, të cilat rezultojnë të ndryshme në momentin e krijimit të tyre deri në momentin e shitjes përfundimtare dhe, për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson si të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është i domosdoshëm një akt ekspertimi në mënyrë që të paguhet ky detyrim ligjor.

21.2. Pavarësisht sa më sipër, të ardhurat nga shitja e kuotave janë marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer në Komision⁵⁸ dhe, për këtë arsye, në përputhje me standardin e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, si dhe duke pasur në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit⁵⁹, trupi gjykues vlerëson se diferenca e pajustificuar me burime të ligjshme duhet të ngelet në vlerën e llogaritur në analizën financiare të kryer në Komision për llogaritjet e kryera deri në datën 31.12.2016.

22. Në lidhje me shkakun e ankimit se të ardhurat në analizën financiare për periudhën 1995 - 2002⁶⁰, janë më të larta nga sa Komisioni i ka llogaritur, trupi gjykues vëren se të ardhurat prej 3.975.006 lekësh, për periudhën para vitit 2003, që i rezultuan Komisionit në rezultatet e hetimit, datë 29.07.2019, janë rishikuar nga Komisioni në vendim, përkatësisht në vlerën prej 4.207.656 lekësh, duke përfshirë në llogaritje edhe të ardhurat nga lejet e lindjeve të subjektit të rivlerësimit në vitet 1996, 1997 dhe 2000, përkatësisht në vlerën prej 232.650 lekësh.

22.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat deri në vitin 2002, pa përfshirë të ardhurat e lejes së lindjes, ishin në vlerën prej 6.099.444 lekësh. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, si dhe paga dhe pagesa e papunësisë së bashkëshortit për këtë periudhë, rezultojnë të jenë në shumën e llogaritur nga Komisioni prej 3.975.006 lekësh⁶¹, dhe me

⁵⁷ Neni 8, pika 1, shkronja “f” e ligjit nr. 8438/1998, parashikon se: “[...] 1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: [...] f) të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, që një ortak ose aksionar zotëron dhe ia shet një personi tjetër [...]”.

⁵⁸ Paragrafi 50.2 i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁵⁹ Vendimi nr. 25/2020 (JR) i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

⁶⁰ Të cilat duhet të ishin llogaritur në vlerën prej 3.975.006 lekësh.

⁶¹ Përkatësisht, të ardhurat nga paga si gjyqtare për periudhën shtator 1996 - 2002, shumën prej 2.374.139 lekësh, të ardhurat e bashkëshortit nga paga nga Këshilli i Rrethit Ersekë për periudhën mars 1996 - 1998, në shumën prej 186.344 lekësh, pagesë papunësie për bashkëshortin nga DRSSH Kolonjë për periudhën janar - korrik 1997, në shumën prej 14.404 lekësh, të ardhura të bashkëshortit nga paga nga Partia Socialiste Ersekë për periudhën 1998 - 2002, në shumën prej 1.210.222 lekësh, të ardhurat e bashkëshortit si kryetar i Këshillit Bashkiak Ersekë, në periudhën

të drejtë Komisioni ka përjashtuar nga këto të ardhura shumën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, prej 2.124.438 lekësh, me burim shpërndarjen e dividendit nga shoqëria “{***} ShPK”.

22.2. Duke përjashtuar nga analiza financiare për verifikimin e mundësisë financiare për burimet dhe të ardhurat e ligjshme për pasuritë e deklaruara në deklaratën e personit që mbartte detyrim për deklarim pasurie në vitin 2003, të ardhurat e pretenduara për bashkëshortin nga shoqëria “{***} ShPK”, dhe duke përfshirë në llogaritje të ardhurat nga leja e lindjes së subjektit të rivlerësimit për periudhat nëntor 1996 - prill 1997 dhe shkurt - qershor 2000, në total në shumën prej 232.650 lekësh⁶², trupi gjykues vëren se të ardhurat e ligjshme për periudhën deri në vitin 2002, rezultojnë në shumën 4.207.656 lekë. Për këtë arsye, është i pambështetur pretendimi se të ardhurat për këtë periudhë ishin në shumën 6.099.444 lekë.

22.3. Rrjedhimisht, të ardhurat e justifikuara me burime të ligjshme për periudhën deri në vitin 2002, në shumën prej 4.207.656 lekësh, trupit gjykues nuk i rezultuan të mjaftueshme për çeljen e depozitës në vitin 2002, në shumën prej 5.408.181 lekësh në {***}⁶³, e cila është përdorur si burim krijimi për pasurinë apartament 80,6 m² në Ersekë, e cila më pas ka shërbyer për krijimin e depozitës në Fondin e Investimeve në {***}, deklaruar në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë.

22.4. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se Komisioni, në rezultatin e analizës financiare për periudhën 1995 – 2002, nuk ka përfshirë asnjë shpenzim jetese për familjen e subjektit të rivlerësimit, përfshirja e të cilave, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, do të rëndonte diferencën e pajustificuar me burime të ligjshme për të justifikuar pasuritë e deklaruara në deklaratën e personit që mbartte detyrim për deklarim pasurie në vitin 2003. Për këtë arsye, duke e vlerësuar këtë rrethanë në dritën e parimit të mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vlerëson se rezultati i analizës financiare, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive për këtë periudhë, duhet të ngelet në vlerën e llogaritur në Komision.

22.5. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se nuk janë përfshirë të ardhurat nga lejet e lindjes në vitet 1996, 1997 dhe 2000, trupi gjykues vëren se Komisioni në analizën financiare, në të ardhurat para vitit 2003, ka përfshirë të ardhurat nga lejet e lindjeve të subjektit të rivlerësimit në këto vite, në shumën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit prej 232.650 lekësh⁶⁴, dhe për këtë arsye pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur.

22.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ka pasur të ardhura nga blegtoaria në vitet 1993 - 1998, nga mbajtja e një tufe të gjësë së gjallë, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit

tetor 2000 - 2002, në shumën prej 70.929 lekësh dhe të ardhurat nga shpërblimet si këshilltar i Këshillit të Qarkut Korçë në periudhën 2001 – 2002, në shumën prej 118.968 lekësh.

⁶² Ashtu siç dhe subjekti ka analizuar në përgjigje të rezultateve hetimore datë 9.09.19, në paragrafin 9.4, por nuk i ka përfshirë në analizën në formë tabele në faqen 6 të tij.

⁶³ Vërtetimi nr. {***} prot., datë 14.06.2009, i {***}.

⁶⁴ Përkatësisht shumën prej 104.462 lekësh për lejet e lindjes për periudhën tetor 1996 - prill 1997, dhe shumën prej 128.188 lekësh për lejet e lindjes për periudhën janar - korrik 2000.

nuk ka deklaruar të ardhura nga blegtoria në deklaratën e personit që mbartte detyrim për deklarim pasurie në vitin 2003 apo në deklaratën *vetting* dhe nuk ka paraqitur prova që të vërtetojnë të ardhura nga blegtoria për këtë periudhë. Për këto arsye, trupi gjykues, bazuar në nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit⁶⁵, pretendimet për krijimin e të ardhurave nga kultivimi i kulturave blegtorale, vlerëson se mbetën në nivel deklarativ dhe nuk gjetën mbështetje në dokumentacion.

23. Për sa i përket shkakut të ankimit për analizën financiare për vitet 2003 - 2016, trupi gjykues vëren se Komisioni ka konsideruar si të ligjshme, të ardhurat e dokumentuara nga punësimi i bashkëshortit në SHBA, në vitet 2007 - 2008, në shumën prej 14.588 USD, nuk ka konsideruar si të ligjshme të ardhurat e pretenduara prej 100.000 lekësh nga qiraja e lokalit me sip. 90 m², në Ersekë, në vitin 2015, për shkak të mospagimit të tatimit⁶⁶, nuk ka konsideruar si të ligjshme të ardhurat e pretenduara për bashkëshortin në shumën prej 24.161.748 lekësh, nga shpërndarja e dividendit të shoqërisë “{***} ShPK”, dhe ka përfshirë në llogaritje të ardhurat që nuk janë deklaruar në deklaratën *vetting*, por që Komisionit i kanë rezultuar të provuara dhe në deklarinimet para ILDKPKI-së, sipas procesverbalit të datës 02.03.2015⁶⁷.

23.1. Trupi gjykues vëren se kontrolli për kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, nuk është realizuar nga Komisioni në përputhje me përcaktimet e nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, pra për të kontrolluar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për të justifikuar me burime të ligjshme pasuritë e deklaruar në pronësi, përdorim apo posedim në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë. Kjo mënyrë kontrolli, për rrjedhojë ka sjellë mungesë konkluzionesh nga Komisioni për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të pasurisë së deklaruar në deklarinimin e rivlerësimit të pasurisë, duke devijuar konkluzionet për këtë kriter, bazuar në analizën financiare vjetore për periudhën 2003 - 2016.

23.2. Për kryerjen e analizës financiare për periudhën 2003-2016, Komisioni, si në rezultatet e hetimit, ashtu edhe në vendim, për secilën pasuri, është mbështetur në dokumentet e administruara në fashikuj, duke arsyetuar në mënyrë të detajuar përfshirjen e çdo të ardhure të cilën e ka konsideruar të ligjshme dhe çdo shpenzim të kryer, sikurse rezultojnë të arsyetuara nga Komisioni në vendim edhe shkaqet e mospërfshirjes së atyre të ardhurave që nuk janë konsideruar të ligjshme.

⁶⁵ Vendimet nr. 9/2020 (JR), nr. 26/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

⁶⁶ Paragrafin 44.5 të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁶⁷ Përkatësisht: të ardhura nga lejet e lindjeve SR (vitet 1996, 1997 dhe 2000) prej 232.650 lekësh; pagesë papunësie nga DRSSH Kolonjë janar - korrik 1997 prej 14.404 lekësh; të ardhura nga dëmshpërblimi për automjetin e dëmtuar, nga shoqëria {***} (13.04.05) prej 750.000 lekësh – deklaruar në DV 2005; të ardhura nga shitja e automjetit {***} më 1.09.2006, prej 371.109 lekësh - deklaruar në procesverbalin e datës 2.03.15; të ardhura nga interesat, një total prej 730.798 lekësh – deklaruar në deklaratat vjetore ndër vite; dhuratë nga vëllai i bashkëshortit prej 358.960 lekësh – deklaruar në DV 2014; të ardhura nga pensioni ISSH për vajzat A. M. dhe A. M., prej 39.960 lekësh – deklaruar në DV 2016.

23.2.1. Në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit⁶⁸ lidhur me *shpenzimet vjetore*, Komisioni i ka bërë të njohur subjektit të rivlerësimit përfshirjen në llogaritje të zërave përkatës, në mënyrë të përmbledhur, dokumentet dhe provat ku Komisioni ishte mbështetur, metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve të jetesës sipas ILDKPKI-së⁶⁹, metodologjinë e përcaktimit të shpenzimeve të udhëtimit që rezultuan nga sistemi TIMS, përfshirjen e shpenzimeve të marrjes me qira të tokës bujqësore, të shpenzimeve të shkollimit të fëmijëve, të shpenzimeve të kryera për pagesat me kartë në {***}, sikurse dhe të shpenzimeve të jetesës në Angli, të vajzës, znj. A. M.⁷⁰.

23.2.2. Për sa i përket llogaritjes së likuiditeteve, trupi gjykues vëren se Komisioni, përfshirjen në llogaritje të shumave përkatëse, e ka mbështetur në vërtetimet e institucioneve financiare, ndërsa për sa i përket gjendjes *cash*, Komisioni përfshirjen në llogaritje të shumave përkatëse e ka mbështetur në deklaratimet e interesave periodikë/vjetorë⁷¹.

23.2.3. Trupi gjykues vëren se Komisioni ka kryer analizën financiare të secilit vit, duke përfshirë në llogaritje të ardhurat e krijuara gjatë vitit, që kanë rezultuar të dokumentuara, duke i zbritur shpenzimet e kryera gjatë vitit, pasuritë e vendosura në vitet përkatëse, si dhe duke zbritur dhe diferencën e likuiditeteve në bankë dhe në formë *cash*, sipas deklarimeve⁷². Në rastet kur subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me diferencë të pajustificuar me burime të ligjshme, Komisioni ka mbledhur diferencat e pajustificuara me burime të ligjshme të çdo viti, për të arritur në përfundime⁷³ lidhur me mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit.

23.3. Për sa i përket pretendimit mbi të ardhurat nga qiraja e lokalit në vitin 2015, trupi gjykues vëren se në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat prej 100.000 lekësh, sipas kontratës së qirasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.01.2015⁷⁴, të lidhur me individin I. H.⁷⁵, çmimi 5.000 lekë/muaj⁷⁶, ndërkohë që nga shkresa nr. {***} prot., datë 08.02.2019, e {***}, rezulton se në llogari të z. A. M. ka kaluar shuma prej 100.000 lekësh, me përshkrimin: “[...] I. H., derdhje likuidim qira lokali [...]”. Nga shkresa *kthim përgjigje* nr. {***} prot., datë 19.04.2019, e DRTK-së, nuk rezulton pagesa e tatimit në burim mbi qiranë e mësipërme dhe, në këto kushte, mbetet i papërbushur detyrimi i parashikuar nga neni 8, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr.

⁶⁸ Paragrafët 32 - 37 të rezultateve të hetimit datë 29.07.2019.

⁶⁹ Metodologji e njohur edhe për Kolegjin.

⁷⁰ Lëvizjet e llogarive bankare në {***}, sipas shpjegimeve në pyetësorin nr. 1.

⁷¹ Paragrafi 44.1, i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁷² Diferenca e gjendjes së likuiditeteve në fund të vitit të analizës me gjendjen së likuiditeteve në fillim të vitit të analizës, sipas gjendjes së likuiditeteve në bankë referuar lëvizjes së llogarive bankare dhe ndryshimet e likuiditeteve në *cash* sipas deklarimeve në deklaratat vjetore ndër vite si i vetmi dokument ku ato janë deklaruar] e cila përbën pasuri të krijuar në formë likuiditeti [kur ka shtesë likuiditeti] apo dhe pasuri të përdorur [pakësim likuiditeti] për krijimin e ndonjë pasurie tjetër apo përballimin e shpenzimeve.

⁷³ Paragrafi 50 dhe 65 i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁷⁴ Qiradhënës z. A. M., qiramarrës z. I. H., objekti, lokali me sip. 90 m², kohëzgjatja 01.11.2014 - 01.11.2019.

⁷⁵ Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit pretendon që z. I. H. e kishte marrë ambientin me qira për ushtrim aktiviteti, kontrata e qirasë rezulton se është lidhur me individin I. H., për rrjedhojë qiramarrësi nuk ishte një subjekt tregtar.

⁷⁶ Neni 5 i të cilit parashikonte se: “[...] Qiradhënësi do të paguajë tatimin e pasurisë dhe masës së qirasë në masën e përcaktuar nga ligji për këtë qëllim”.

8438/1998, i ndryshuar⁷⁷. Për këtë arsye, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, kjo e ardhur nuk mund të konsiderohet e ligjshme për procesin e rivlerësimit.

23.4. Për sa u përket shpenzimeve të mobilimit të apartamentit me sip. 80,6 m², në Ersekë, me vlerë 1.700.000 lekë, në vitin 2005, trupi gjykues vëren se në deklaratën *vetting*, të ardhurat e pretenduara si të krijuara nga shitja e tyre në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar si burim të krijimit të depozitës te Fondi i Investimeve në {***}, me vlerë prej 3.500.000 lekësh.

23.4.1. Duke analizuar deklaratimet në deklaratën e pasurisë *vetting* me deklaratimet e interesave privatë periodikë/vjetorë, trupi gjykues vëren se në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shpenzime të kryera për mobilimin e apartamentit me sip. 80,6 m² në Ersekë, ndërsa në vitin 2015, ka deklaruar se nga shitja e tyre ka përfituar shumën prej 1.640.000 lekësh. Duke vlerësuar provat lidhur me mungesën e deklaratimit në vitin 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *vetting*, ka paraqitur kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 0.04.2015, nga e cila rezulton e vërtetuar shitja e apartamentit me sip. 80,6 m², në Ersekë, në vlerën 1.860.000 lekë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *vetting*, ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2015, sipas së cilës shitësit, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, përveç apartamenti me sip. 80,6 m² në Ersekë, në pronësi të blerësit, z. D. M., kanë transferuar edhe sendet që i shërbenin këtij apartamenti, sikurse “[...] orenditë shtëpiake si dhe ambiente të tjera ndihmëse (depo, dush) [...]”, në vlerën prej 1.640.000 lekësh, shumë e cila rezulton që të jetë kredituar nga blerësi në datën 30.03.2015, në llogari të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në {***}, me përshkrimin “blerje pajisje shtëpie”⁷⁸.

23.4.2. Pavarësisht terminologjisë së përdorur në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2015 dhe shkresës së titulluar “pagesë me të tretët”, datë 30.03.2015, të {***}, trupi gjykues vëren se në kontratën e shitjes, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të tij, në cilësinë e shitësve, dhe blerësit z. D. M., objekt i saj ishin sendet aksesorë të apartamentit me sip. 80,6 m² në Ersekë, të cilat në rastin konkret, në përputhje me nenin 148, paragrafi i dytë i Kodit Civil⁷⁹, nuk janë disponuar së bashku më sendin kryesor, por kanë qenë objekt disponimi në mënyrë të veçantë, duke krijuar të ardhura më vete, dhe në përputhje me nenin 473, paragrafi i parë i Kodit Civil⁸⁰, rezulton i ekzekutuar detyrimi kontraktor.

23.4.3. Komisioni nuk e ka konsideruar të ligjshme të ardhurën prej 1.640.000 lekësh nga sendet aksesorë, nisur nga vlera relativisht e lartë e shitjes së tyre, duke krijuar bindjen se apartamenti me sip. 80,6 m² në Ersekë, ishte shitur në vlerën prej 3.500.000 lekësh, që për Komisionin përbën

⁷⁷ Neni 8, pika 1, shkronja “d” e ligjit nr. 8438/1998, parashikon se: “1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatuashme: [...] d) të ardhurat nga [...] qiratë, me përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar [...]”.

⁷⁸ Shkresa pagesë e brendshme, datë 30.03.2005, e {***}, referenca {***}.

⁷⁹ Neni 148, paragrafi i dytë i Kodit Civil, parashikon se: “Aksesorët mund të jenë edhe objekt i një disponimi të veçantë”.

⁸⁰ Neni 473, paragrafi i parë i Kodit Civil, parashikon se: “Për çdo pagesë të kryer në ekzekutim të detyrimit, kreditori jep një dëftesë, përveç kur rezulton ndryshe nga kontrata”.

shumën që i korrespondonte çmimit të shitjes së apartamentit, si dhe duke konsideruar se ndarja e vlerës së shitjes së apartamentit ishte bërë për të shmangur pagesën e tatimit mbi të ardhurat.

23.4.4. Trupi gjykues vlerëson se dyshimet e Komisionit që kishin nisur nga vlera relativisht e lartë e shitjes së sendeve aksesorë, nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanave, në mënyrë të ndryshme nga aktet noteriale dhe shkresa bankare, në kushtet kur bindja e Komisionit lidhur me shitjen e sendeve nuk është shoqëruar me shkaqe pavlefshmërie të veprimit juridik, sipas parashikimeve të nenit 92 të Kodit Civil dhe, në kushtet kur palët në kontratë, në përputhje me nenin 660 të Kodit Civil, kanë të drejtë të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi.

23.4.5. Bazuar në nenin 49, pikat 1 e 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se aktet noteriale dhe shkresa bankare janë në pajtueshmëri të dukshme, për arsye se nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.04.2015, vërtetohet përjashtimi i disponimit të sendit kryesor së bashku me sendin aksesor, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2015, vërtetohet shitja në mënyrë të veçantë e sendeve aksesorë, dhe nëpërmjet shkresës *pagesë e brendshme*, datë 30.03.2005, e {***}, vërtetohet edhe ekzekutimi i detyrimit.

23.4.6. Për këto arsye, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e krijuara nga shitja e mobilieve të apartamentit me sip. 80,6 m², në Ersekë, duhet të konsiderohen si të ligjshme, për arsye se ato janë sende aksesorë, të disponuara së bashku me sendin kryesor.

23.4.7. Në këto kushte, duke e llogaritur vlerën e mobilimit prej 2.000.000 lekësh, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit për vitin 2005, do të rezultonte me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë për vitin 2005, në një vlerë më të lartë nga sa i ka rezultuar Komisionit, përkatësisht nga diferenca e pajustificuar me burime të ligjshme në shumën prej (-) 1.881.849 lekësh në shumën prej (-) 3.881.849 lekësh, rrethanë të cilën trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson në dritën e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit, ndaj rezultati i analizës financiare për këtë periudhë duhet të ngelet në vlerën e llogaritur në Komision për vitin 2005. Për një analizë garantiste, trupi gjykues vëren se edhe me përfshirjen në analizën financiare të vlerës së sendeve aksesorë të apartamentit me sip. 80,6 m², në Ersekë, në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit sërish do të rezultonte me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në diferencën prej (-) 514.194 lekësh.

23.5. Për sa u përket të ardhurave prej 3.000 eurosh, të përfituara nga shitja e automjetit tip “{***}” në vitin 2006, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendon se kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit tip “{***}” në vitin 2006, duke analizuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se në deklaratën *vetting*, për blerjen e automjetit tip “{***}” në vitin 2006, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit, ndërsa në deklaratën e interesave periodikë/privatë të vitit 2006, nuk e ka deklaruar si burim krijimi për këtë pasuri, por e ka

deklaruar atë si burim krijimi në procesverbalin e datës 02.03.2015, të mbajtur pranë ILDKPKI-së⁸¹.

23.5.1. Duke i vlerësuar deklaramet e subjektit të rivlerësimit në raport me aktet në dosje, rezulton se automjeti tip “{***}” është blerë nga bashkëshorti në datë 27.02.2006, nga shoqëria “{***} ShPK”, duke u parapaguar në datën e lidhjes së kontratës, vlera prej 5.200 eurosh, ndërsa pjesa tjetër prej 9.800 eurosh, do të kryhej brenda “[...] 8 ditëve të kolaudimit të mjeteve nga firma “{***}” ShPK [...]”⁸². Nga ana tjetër, shitja e automjetit tip “{***}” është kryer nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***}kol., datë 01.09.2006, jo nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, por nga shoqëria “{***} ShPK”, dhe në një distancë kohore prej afërsisht shtatë muajsh më vonë nga blerja e automjetit tip “{***}”.

23.5.2. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën, datë 02.09.2019, të shoqërisë “{***} ShPK”, nga e cila rezulton se shuma prej 3.000 eurosh nuk është përfituar nga shoqëria “{***} ShPK”⁸³, që në përputhje me nenin 191 të Kodit Civil, përbën një bazë të mjaftueshme provuese se shoqëria “{***} ShPK” kishte hequr dorë nga pronësia mbi automjetin tip “Nissan” dhe përfitues i kësaj shume ishte bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, por në kundërshtim me nenet 30 e në vijim të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikën 7 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë momentin e krijimit të shumës prej 3.000 eurosh.

23.5.3. Pavarësisht këtyre rrethanave, trupi gjykues vëren se, duke qenë se Komisioni e ka konsideruar si të ardhur të ligjshme shumën e përfituar nga shitja e automjetit “{***}”, duke e përfshirë atë në analizën financiare për periudhën 2003 - 2016, në vlerën e konvertuar prej 371.109 lekësh, trupi gjykues i Kolegjit, në dritën e mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit në ankim, vlerëson se rezultati i analizës financiare për këtë periudhë duhet të ngelet në vlerën e llogaritur në Komision për analizën financiare të vitit 2006.

23.6. Për sa u përket shpenzimeve për kostot e jetesës për periudhën 2003 - 2016, trupi gjykues vëren se, në tërësi, shpenzimet e jetesës në analizën financiare të Komisionit, janë llogaritur sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI-ja, në përputhje me të dhënat statistikore të INSTAT-it, sipas viteteve.

23.6.1. Në mënyrë të veçantë për vitin 2007, shpenzimet për kostot e jetesës janë llogaritur sipas të dhënave statistikore të INSTAT-it, që i përkasin vitit 2008, përkatësisht në vlerën prej 136.620 lekësh, konsum vjetor për frymë, me arsyetimin se vlerat statistikore për vitin 2007, Komisionit i

⁸¹ Të administruar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 27.06.2019.

⁸² Nenet 7, 10 të kontratës së shitjes, datë 27.02.2006, ndërmjet shitësit “{***}ShPK” dhe blerësit, z. A. M..

⁸³ Sipas shkresës, datë 02.09.2019, të shoqërisë “{***} ShPK”: “Mjeti {***} ka qenë në pronësi të shoqërisë, blerë gjatë vitit 2004, kur A. M. ka qenë administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë. Në vitin 2005, ky mjet nuk ka qenë në aktivitet dhe makineritë e shoqërisë pasi ishte nxjerrë nga qarkullimi. Veprimet që ka kryer A. M. më pas, me mjetin e dëmtuar, nuk kanë qenë në interesat e shoqërisë dhe vlera e kontratës së shitjes nuk është derdhur asnjëherë në arkën e shoqërisë”.

rezultonin shumë të larta krahasuar me vitet e tjera, përkatësisht 235.968 lekë, konsum vjetor për frymë⁸⁴.

23.6.2. Për sa u përket shpenzimeve të jetesës për frymë në vitet 2007 - 2008, periudhë në të cilën familja ishte përbërë nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe dy vajzat, ndërkohë që bashkëshorti kishte emigruar në ShBA, Komisioni shpenzimet e jetesës i ka llogaritur duke u bazuar në të dhënat statistikore të ILDKPKI/INSTAT për katër persona, por nga ana tjetër Komisioni, në përputhje me parimin e objektivitetit, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka përfshirë në llogaritje shpenzimet e jetesës së bashkëshortit në ShBA.

23.6.3. Lidhur me analizën financiare për periudhën janar - dhjetor 2016, gjatë së cilës vajza, znj. A. M., ishte me studime në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioni, shpenzimet e jetesës i ka llogaritur në vlerën prej 646.503 lekësh⁸⁵ për familjen në tërësi, ndërsa shpenzimet e vajzës, sipas parashikimeve të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i ka llogaritur jo për të gjithë vitin 2016, por vetëm për një muaj, që përkon me pushimet vjetore.

23.6.4. Për sa i përket pretendimit të subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës, të shpenzimeve të ushqimit të vajzave, znj. A. M. dhe znj. A. M., për periudhën 2007 - 2011 dhe të vajzës, znj. A. M., për periudhën 2012 - 2014, për shkak të përfshirjes në pagesën e shkollimit në këtë periudhë në shkollën jopublike “{***}”, trupi gjykues vëren se rezulton e vërtetuar⁸⁶ pagesa vjetore e shkollimit në shumën prej 135.000 lekësh. Sikurse ka shpjeguar subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, dhe nga vërtetimi nr. {***} prot., datë 01.02.2019, i shkollës 12-vjeçare jopublike “{***}”, rezulton se në pagesën vjetore prej 135.000 lekësh, përveç tarifës së shkollimit për procesin mësimor, përfshihej edhe ushqimi për “[...] vaktet mëngjes e drekë”.

23.6.4.1. Trupi gjykues, ndërthurjen e këtij elementi në shpenzimet e jetesës së viteve 2007 - 2014, e vlerëson jodomethënës për rezultatet e analizës financiare për këtë periudhë, në kushtet kur do të përfaqësonin një pjesë jothelbësore të pagesës vjetore të shkollimit prej 135.000 lekësh. Nga ana tjetër, shpenzimet e jetesës për secilin vit janë dukshëm më të larta se pagesa në total e shkollimit, përkatësisht në vitet 2007 - 2011, për secilin vit, në vlerën prej 546.480 lekësh; në vitin 2012, në vlerën prej 558.192 lekësh; në vitin 2013, në vlerën prej 564.096 lekësh dhe; në vitin 2014, në vlerën prej 879.992 lekësh.

23.6.5. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e udhëtimit, trupi gjykues vëren se nga analiza financiare në vitin 2004⁸⁷, subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar

⁸⁴ Paragrafi 32 i rezultateve të hetimit datë 29.07.2019.

⁸⁵ Si total i: Për 8 muaj (pasi në shtator bashkëshorti i subjektit ndahet nga jeta) për familje me 3 veta (subjekti, bashkëshorti dhe vajza A.) [familje me 3 veta prej 705.276 në vit/ 12 muaj x 8 muaj = 470.184 lekë], për 4 muaj për familje me 2 veta (subjekti dhe vajza A.) [familje me 2 veta prej 470.184 në vit/ 12 muaj x 4 muaj = 156.728 lekë] dhe për gushtin shpenzime jetese dhe për vajzën A. M. pasi është kthyer në Shqipëri në verë [familje me 1 person prej 235.092 në vit/ 12 muaj x 1 muaj = 19.591 lekë].

⁸⁶ Shkresa nr. {***} prot., datë 22.05.2019 e Shkollës Jopublike “{***}”.

⁸⁷ Lidhur me shpenzimet për udhëtimet dhe qëndrimin në SHBA, në Mbretërinë e Bashkuar dhe Greqi.

me mundësi të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë. Ndërkohë, në funksion të një analize financiare edhe në rastin nëse për periudhën 2004 – 2016, në të cilën shpenzimet e udhëtimit janë të llogaritura në vlerën prej 7.798.986 lekësh, nuk do të përfshihej asnjë shpenzim udhëtimi, sërish subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mundësi të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën, përkatësisht në diferencën prej (-) 12.715.562 lekësh, nga vlera e llogaritur në Komision prej (-) 19.514.051 lekësh.

23.6.6. Për sa i përket tërësisë së pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me rezultatin negativ të të ardhurave me shpenzimet e kryera, trupi gjykues vëren se totali i të ardhurave për periudhën 1995 – 2016, rezulton në shumën prej 38.103.705 lekësh⁸⁸, totali i shpenzimeve në vlerën prej 25.120.844 lekësh, dhe në kushtet kur pasuritë e krijuara për këtë periudhë janë në vlerën prej 27.535.998 lekësh⁸⁹, raporti i pasurive të subjektit të rivlerësimit me pasuritë e konsideruara të ligjshme, është në vlerën 1,99.

23.6.7. Për sa i përket gjendjes *cash*, sipas subjektit të rivlerësimit, të padeklaruar për shkak të mosndërgjegjësimit, trupi gjykues vëren se në ILDKPKI⁹⁰, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 40.000 eurosh, me burim nga kursimet ndër vite nga pagat dhe aktiviteti privat i bashkëshortit, ndërsa sipas deklaratave të interesave periodikë/vjetorë, subjekti i rivlerësimit do të kishte shumën 17.200 USD⁹¹ dhe 25.000 euro⁹², ose të konvertuara në vlerën e përafërt prej 38.385 eurosh.

23.6.7.1. Trupi gjykues vëren se në përgjigje të rezultateve të hetimit datë 29.07.2019, sipas analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, kursimet në fund të vitit 2016, të padeklaruara në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë, ishin në vlerën prej 6.170.391 lekësh, dhe të deklaruara në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë, ishin përkatësisht në shumën prej 5.200 USD dhe 3.000 eurosh. Nga analiza e kryer në Kolegj, duke zbritur nga shuma totale e mësipërme, përafërsisht prej 7.228.019 lekësh, vlerën e depozitës së çelur në datën 25.01.2017, në {***}, prej 30.000 eurosh, të konvertuar në vlerën prej 4.120.959 lekësh, me burim pakësimin e gjendjes *cash*⁹³, kursimet e mbetura në *cash* do të rezultonin në shumën prej 3.107.060 lekësh.

23.6.7.2. Trupi gjykues vlerëson se deklaratat e subjektit të rivlerësimit lidhur me gjendjen *cash* në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë dhe pas rezultateve të hetimit, sipas parashikimeve të

⁸⁸ Në krahasim me shumën në tabelë kolona e fundit "Totali" prej 37.732.597 lekë është shtuar dhe vlera e pa mbledhur në total prej 371.109 lekë - e ardhur në vitin 2006.

⁸⁹ Nga totali prej 27.535.998 lekë i Pasuri neto sipas tabelës në faqen 22 të vendimit, duke zbritur vlerën e apartamentit në Ersekë prej 1.700.000 lekë (blerë në vitin 2005) që është shitur më pas në vitin 2015 dhe në analizë është konsideruar vlera e të ardhurave nga shitja prej 1.860.000 lekë.

⁹⁰ Pyetja nr. 12 e procesverbalit datë 02.03.2015 të ILDKPKI-së.

⁹¹ Si rezultat i deklarimeve, në USD në vitin 2005 - shtesa prej 7.000 USD, në vitin 2006 - shtesa prej 5.000 USD, në vitin 2008 - shtesa prej 20.000 USD, në vitin 2010 - pakësimi prej 14.800 USD.

⁹² Si rezultat i deklarimeve, në vitin 2009 - shtesa prej 10.000 eurosh, në vitin 2010 - shtesa prej 10.000 eurosh, në vitin 2011 - shtesa prej 5.000 eurosh.

⁹³ Sipas deklarimeve në deklaratën vetting.

nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk janë në pajtueshmëri të dukshme me pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, sipas së cilës gjendja *cash* ishte në vlerën prej 1.000.000 lekësh⁹⁴.

23.6.7.3. Për sa i përket mundësisë së kursimit të gjendjeve *cash*, përkatësisht: a) të shumave prej 17.200 USD dhe prej 25.000 eurosh, të deklaruara në deklaratat e interesave periodikë/vjetorë 2005 - 2013, shuma të cilat janë të përafërta me deklarinimin e dhënë në ILDKPKI për këtë periudhë, në shumën prej 40.000 eurosh; b) të shumës prej 300.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën e interesave periodikë/vjetorë 2014; dhe c) të shumës prej 1.000.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën *vetting*⁹⁵, nga analiza e kryer në Kolegj, trupi gjykues vëren se në vitet e deklarimit të gjendjes *cash*, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e shpenzimet e kryera dhe, rrjedhimisht, ka qenë në pamundësi për të justifikuar me burime të ligjshme gjendjet *cash* të deklaruara në deklaratën *vetting*, prej 1.000.000 lekësh dhe depozitës prej 30.000 eurosh, të çelur në {***}, në datën 25.01.2017.

24. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim ankimin dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimet se subjekti i rivlerësimit, për periudhën deri në dorëzimin e deklaratës *vetting*, ka kryer deklarinim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, për arsye se nga analiza financiare, subjekti i rivlerësimit rezulton se gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera.
25. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Brunilda Malo (Orhani) gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si edhe nga pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë, vendimi nr. 206, datë 07.11.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e saj nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁹⁴ Në një vlerësim të kundërt, do të pranohej se subjekti i rivlerësimit kishte shpenzuar shumën prej 2.107.060 lekësh për muajin janar 2017, vetëm për shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit dhe të vajzës së saj, në kushtet e moskryerjes së udhëtimeve në këtë periudhë.

⁹⁵ Paragrafi 44.1 i vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 206, datë 07.11.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Brunilda Malo (Orhani).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 23.02.2022.

ANËTAR

ANËTARE

ANËTARE

Sokol ÇOMO

Ina RAMA

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

nënshkrimi

nënshkrimi

RELATORE

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

Natasha MULAJ

nënshkrimi

nënshkrimi